

AMF miraton udhëzimin për sistemin “*Bonus-Malus*”

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, shkurt 2019

Zhvillime të tjera

- AMF do të organizojë Konferencën e dytë Kombëtare “Edukimi Financiar”
- Autoriteti fton dhënien e opinioneve mbi ndryshimet në Rregulloren “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”
- *Workshop* për *kriptomonedhat* dhe efektet e tyre
- Dedikuar mbrojtjes së investitorëve e konsumatorëve
- Takim me Komisionin e Letrave me Vlerë në Maqedoninë e Veriut
- AMF rrit transparencën, publikim i ri për tregun e sigurimeve
- Zhvillohet Konferenca e 20-të vjetore e Bursës në Maqedoninë e Veriut

Edukimi i Konsumatorit

- Të kursesh mjaftueshëm, mirë dhe në mënyrë inteligjente (*pjesa e parë*)

Botime Profesionale

Lajme Ndërkombëtare

- Bullgari
- Kroaci
- Hungari
- Poloni
- Rumani
- Sllovaki
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

AMF miraton udhëzimin për sistemin “*Bonus-Malus*”

Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ka miratuar udhëzimin “Mbi zbatimin e sistemit “*Bonus-Malus*” në sigurimin MTPL e brendshme”. Udhëzimi përcakton kriteret për llogaritjen e skemës universale të sistemit “*Bonus-Malus*” që do të zbatohet nga të gjitha shoqëritë e sigurimit që ofrojnë produktin TPL e brendshme në kategoritë B1 (autovetura) dhe B2 (furgona, mikrobuzë).

Udhëzimi u miratua nga Bordi i Autoritetit në pritje të ndryshimeve të plota ligjore me qëllim kryesor mbrojtjen e konsumatorit dhe përfshirjen e praktikave të njohura evropiane edhe në tregun shqiptar të sigurimeve. Në vendet ku është në zbatim sistemi “*Bonus-Malus*” **ka dhënë efekte në uljen e numrit të aksidenteve, mbrojtjen e jetës së qytetarëve dhe garantimin e një çmimi më të drejtë në policat e sigurimit TPL.**

Në aspektin social, me aplikimin e sistemit “*Bonus-Malus*” synohet ndërgjegjësimi i publikut për një drejtim sa më të kujdesshëm të automjetit, por edhe rritje e cilësisë së shërbimit të sigurimeve kundrejt konsumatorëve. Nga ana teknike procesi është më transparent dhe përfshirja e formulave matematikore e bën një mekanizëm të drejtë, të besueshëm dhe sipas meritës.

Sistemi “*Bonus-Malus*” është mekanizmi i tarifimit në sigurimin e detyrueshëm MTPL, ku primi i zbatuar është i varur nga historiku i dëmeve/eksperienca e drejtimit të automjetit nga ana e të siguarit. Ky sistem penalizon ekonomikisht, me rritjen e primit (deri në dyfishimin e tij), të siguarin përgjegjës për një ose më shumë aksidente të shkaktuara/raportuara gjatë periudhës së sigurimit. Në anën tjetër, e favorizon atë me ulje të çmimit të primit të sigurimit (deri në përgjysmim), nëse gjatë periudhës së konsideruar nuk ka shkaktuar asnjë dëm.

Në bazë të udhëzimit të miratuar nga Bordi i Autoritetit, krijimi i historikut për vënien në zbatim të sistemit fillon më 1 prill 2019. Versioni final i udhëzimit të miratuar nga Bordi i AMF-së ka përfshirë mendimin e të gjitha palëve të interesuara. Përveç historikut të dëmeve (“*Bonus-Malus*”) faktorë të tjerë risku që ndikojnë direkt në çmimin e primit të sigurimit janë edhe territori ku qarkullon mjete dhe fuqia motorike e tij.

Sistemi “*Bonus-Malus*” është mekanizmi i tarifimit në sigurimin e detyrueshëm MTPL, ku primi i zbatuar është i varur nga historiku i dëmeve/eksperienca e drejtimit të automjetit nga ana e të siguarit.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, shkurt 2019


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për janar-shkurt 2019 kapën vlerën mbi 2,369 milionë lekë, ose 1.37% më shumë se në periudhën janar-shkurt 2018. Gjatë periudhës janar-shkurt 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 177,450 me një rritje prej 5.59% krahasuar me periudhën janar-shkurt 2018.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 93.08 % të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.76% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.16%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 35.82% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 64.18% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-shkurt 2019, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 0.83 milionë lekë, ose 6.78% më pak se në periudhën janar-shkurt 2018.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për janar-shkurt 2019 kapën vlerën mbi 2,369 milionë lekë, ose 1.37% më shumë se në periudhën janar-shkurt 2018.

Struktura e tregut të sigurimeve, shkurt 2019



■ Pronë dhe të tjera ■ Jetë dhe shëndet ■ Sigurime motorike

ZHVILLIME TË TJERA

AMF do të organizojë Konferencën e dytë Kombëtare “Edukimi Financiar”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të organizojë në datën 23 maj 2019 Konferencën e dytë Kombëtare “Edukimi Financiar”. Kjo konferencë synon të nxisë më tej diskutimet për zhvillimin e tregut të sigurimeve, kapitaleve dhe pensioneve private vullnetare, duke i lidhur ato edhe me rëndësinë e edukimit të vazhdueshëm financiar, gjithnjë e më të gjerë.

Në konferencë ftohen të marrin pjesë studentë dhe pedagogë nga universitete të ndryshme të vendit për të prezantuar punimet më të mira për tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit. Sikurse edhe në konferencën e vitit të kaluar edhe sivjet, punimet e konferencës do të përzgjidhen dhe vlerësohen nga komisioni i cili ka përfaqësues nga AMF dhe shoqatat që veprojnë në tregjet financiare jobankare nën mbikëqyrjen e AMF-së.

—○○○—
Në konferencë ftohen të marrin pjesë studentë dhe pedagogë nga universitete të ndryshme të vendit për të prezantuar punimet më të mira për tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit.
—○○○—



Momente nga konferenca “Edukimi Financiar”, zhvilluar në maj 2018

Konferenca zhvillohet në kuadër të Strategjisë “Për rritjen e besimit të konsumatorit dhe investitorit në tregjet nën mbikëqyrje”, si një angazhim i Autoritetit për rritjen e edukimit financiar.

Datat e rëndësishme, tematikat e konferencës dhe modalitete të tjera të aplikimit për pjesëmarrjen në konferencë, gjenden në linkun [Konferenca Kombëtare “Edukimi Financiar 2019”](#)

Pjesëmarrja në konferencë është e lirë dhe nuk ka tarifë regjistrimi.

Autoriteti fton dhënien e opinionëve mbi ndryshimet në Rregulloren “Për trajtimin e dëmeve që mbulojnë nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka hartuar disa ndryshime të cilat përmirësojnë tabelën aktuale të Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulojnë nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”.

Për të eliminuar interpretimet e ndryshme lidhur me procedurat e trajtimit të dëmeve, që mbrohen nga kontratat e sigurimit për kategorizimin sipas klasave për persona të cilët humbin aftësinë për punë, u angazhua një grup mjekësh me kryesues Prof. Dr. Sokrat Meksi, profesor i mjekësisë ligjore. Grupi i punës ka bërë përcaktimin e saktë të nënkategorive të përqindjeve të humbjes të aftësisë për punë, duke përcaktuar qartazi çdo dëmtim. Kjo do të çojë në shmangien e abuzimeve dhe mbrojtjen e të dëmtuarve në aksidente pasi tani do të ketë çdo grup dhe nëngrup apo klasë dëmtimi të përcaktuar qartazi sa duhet të jetë përqindja e humbjes të aftësisë për punë.

Gjithashtu është përcaktuar formula e përlogaritjes së përqindjes kur kemi më shumë se një dëmtim sipas praktikave më të mira të Bashkimit Evropian si dhe parimet mbi të cilat udhëhiqen mjekët në përlogaritjen e shkallës së dëmtimit në aksidentet rrugore.

Tabela e plotë “Shkalla e Humbjes së Aftësisë së Përhershme në Punë”, është e mbështetur në “*European physical and mental disability rating scale for medical purposes*” të Bashkimit Evropian, si dhe të tabelave analoge të disa vendeve të Ballkanit Perëndimor (Kroaci, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni), me qëllim saktësimin e klasave dhe kategorive përfituese. Përcaktimi i koeficientit të paaftësisë, është bazuar në rregullën e Baltazarit (*La regle de Balthazar*) metodë kjo që përdoret në shumicën e vendeve anëtare të BE-së.

Ky material publikohet me qëllim marrjen e opinionëve apo sugjerimeve nga ekspertë të fushës, shoqata për mbrojtjen e konsumatorëve dhe publiku.

Autoriteti i
Mbikëqyrjes
Financiare ka hartuar
disa ndryshime të
cilat përmirësojnë
tabelën aktuale të
Rregullores nr. 53,
datë 25.06.2009 “Për
trajtimin e dëmeve që
mbulojnë nga
kontrata e sigurimit të
detyrueshëm në
sektorin e transportit”.



UNODC's Global Programme against Money-Laundering, Proceeds of Crime and the Financing of Terrorism



Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC) organizoi në 5-6 mars 2019 në Tiranë një *workshop* në lidhje me *kriptomonedhat* dhe rrezikun e përdorimit të tyre për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Në këtë *workshop* ishin pjesëmarrës përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Bankës së Shqipërisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, si edhe institucioneve dhe agjencive të tjera ligjzbatuese të përfshira në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Në *workshop* u prezantuan:

- Njohuri bazë mbi krijimin dhe funksionimin e *kriptomonedhave*;
- Ruajtja e tyre;
- Përmasat e tregut dhe pjesëmarrësit;
- Transaksionet e bëra përmes *kriptomonedhave*;
- Mundësitë e gjurmimit;
- Mbrojtja nga mashtrimet;
- Rreziku i përdorimit nga rrjetet kriminale;
- *Kriptomonedhat* dhe pastrimi i parave/financimi i terrorizmit;
- Parimet bazë të rregullimit dhe mbikëqyrjes, etj.

Workshop-i u shoqërua me ushtrime praktike dhe diskutime në grup për temat e përmendura më lart.

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC) organizoi në 5-6 mars 2019 në Tiranë një *workshop* në lidhje me *kriptomonedhat* dhe rrezikun e përdorimit të tyre për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Dedikuar mbrojtjes së investitorëve e konsumatorëve

Faqja zyrtare *online* e AMF-së ka një nënrubrikë të veçantë kushtuar mbrojtjes së konsumatorëve. Në këtë rubrikë, e cila përditësohet vazhdimisht, jepen informacione e links edhe të organizmave ndërkombëtare me faqet e tyre në shërbim të konsumatorit.

Në faqen e AMF-së, nënrubrika Kini Kujdes <https://amf.gov.al/kujdes.asp> gjenden gjithashtu paralajmërimet e Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë, (IOSCO). Kjo organizatë ndërkombëtare mbledh së bashku rregullatorët e letrave me vlerë në gjithë botën dhe njihet si hartuese e standardeve globale për sektorin e letrave me vlerë. AMF është anëtare me të drejta të plota në IOSCO, që prej vitit 1998.

Nënrubrika e IOSCO-s në faqen *online* për mbrojtjen e investitorëve https://www.iosco.org/investor_protection/?subsection=investor_alerts_portal shërben si burim informacioni nga autoritetet rregullatore nga shumë vende të botës. Aty pasqyrohen firmat që nuk janë të autorizuar të kryejnë konsulencë në investime në vende të ndryshme dhe u krijohet mundësi investitorëve të shmangin keqinformimet.

Investitorët shqiptarë mund të konsultojnë faqen zyrtare *online* të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare tek Regjistri i të Licencuarve, për shoqëritë që ushtrojnë aktivitet të licencuar në tregun e titujve dhe fondeve të investimeve në vend. Aty gjenden të gjitha subjektet e licencuar nga AMF, për të tre tregjet nën mbikëqyrje.

AMF, në zbatim të objektivit të tij kryesor të mbrojtjes së interesave të investitorëve dhe konsumatorëve, informon rregullisht publikun me anë të paralajmërimeve apo njoftimeve edukative mbi rreziqet e mundshme që lidhen me tipe të ndryshme të investimit apo shërbimeve financiare.



Zhvillohet takimi me Komisionin e Letrave me Vlerë, Maqedoni

Në kuadër të bashkëpunimit midis dy institucioneve, në datën 1 mars 2019, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv Z. Ervin Koçi zhvilloi një takim në Shkup me Zj. Nora Aliti, Kryetare e Komisionit të Letrave me Vlerë të Maqedonisë së Veriut.

Qëllimi i kësaj vizite ishte bashkëpunimi në të ardhmen mbi projektet e ndryshme, si dhe shkëmbimi i eksperiencave më të mira në fushën e mbikëqyrjes së tregut të kapitaleve.



Z. Ervin Koçi, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së dhe Zj. Nora Aliti, Kryetare e Komisionit të Letrave me Vlerë të Maqedonisë, gjatë takimit zyrtar në Shkup

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së vuri theksin në ecurinë e tregut të letrave me vlerë dhe fondeve të investimit në Shqipëri, rëndësinë e këtij tregu duke cilësuar zhvillimet e kuadrit ligjor rregullator, amendimin e dy ligjeve nëpërmjet bashkëpunimit me projektin SECO.

Në takim u identifikuan prioritetet dhe mundësitë e përbashkëta për marrëdhënie më të ngushta, të cilat duhet të kontribuojnë në zhvillimin gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të tregjeve të kapitalit në të dy vendet. U diskutuan projektet deri më tani të realizuara apo ato që janë në proces, dhe iniciativat e ndërmarra për të forcuar integritetin e tregut, mundësitë për instrumente të reja financiare për përmirësimin e performancës institucionale, siç janë investimet në TI dhe infrastrukturën dixhitale, zhvillimin e kapaciteteve operative-profesionale të institucioneve, si dhe alternativat për promovimin e përbashkët të tregjeve të kapitalit dhe të kulturës financiare.

Më tej, Zj. Aliti, Kryetare e Komisionit të Letrave me Vlerë të Maqedonisë së Veriut nënvizoi mundësinë e bashkëpunimit në kuadër të edukimit financiar për të shkëmbyer informacione dhe module për fushat nën mbikëqyrje.

Z. Koçi theksoi se bazuar edhe në strategjinë 2018–2022, AMF ka hartuar një plan konkret sa i përket rritjes së Edukimit Financiar, si një prej objektivave të Autoritetit.

Në kuadër të bashkëpunimit midis dy institucioneve, në datën 1 mars 2019, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv Z. Ervin Koçi zhvilloi një takim në Shkup me Zj. Nora Aliti, Kryetare e Komisionit të Letrave me Vlerë të Maqedonisë së Veriut.

Autoriteti ka caktuar planet dhe modulet e leksioneve, të cilët zhvillohen nga një staf ekspertësh në AMF, ka kryer një sërë konferencash, si edhe ka firmosur marrëveshje bashkëpunimi me Universitete të ndryshme në Shqipëri.

Në përfundim të këtij takimi, i cili shërbeu si një nxitje për të thelluar bashkëpunimin dhe forcimin e marrëdhënieve mes institucioneve, Z. Koçi theksoi gatishmërinë për bashkëpunim të suksesshëm në të ardhmen.

AMF rrit transparencën, publikim i ri për tregun e sigurimeve



Në funksion të transparencës, informimit të publikut dhe rritjes së besimit në tregjet nën mbikëqyrje, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare sjell një publikim të ri tremujor.

“Raporti statistikor financiar për tregun e sigurimeve” sjell informacione statistikore e financiare për tregun e sigurimeve, me qëllim mbrojtjen e interesave të pjesëmarrësve nëpërmjet garantimit të transparencës së plotë.

Duke i shërbyer qëllimit të mbikëqyrjes dhe kërkesave gjithnjë e në rritje të tregut për informacion të specializuar, Autoriteti hartoi këtë publikim të ri me informacion të plotë dhe të strukturuar.

Botimi është i ndarë në tri pjesë dhe në to përfshihet informacioni i përgjithshëm për shoqëritë e sigurimit, informacioni financiar dhe raportet e agreguara të efikasitetit.

Takime shpjeguese për Kapitullin e 2-të “Liria e Lëvizjes së Punëtorëve” organizuar nga Komisioni Evropian

Komisioni Evropian, në kuadër të procesit *screening*, organizoi në Bruksel me datë 13 mars takim shpjegues me përfaqësuesit e Komisionit Evropian, ministrive dhe institucioneve pjesëmarrëse në këta kapituj. Takimi synoi të bëjë një analizë të detajuar dhe të ndihmojë në përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ky takim ka lidhje me shpjegimin e Kapitullit të 2-të “Liria e Lëvizjes së Punëtorëve” – kapitull që drejtohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është kontribues në këtë kapitull në lidhje me:

- Direktivën 98/49 KE e Këshillit, datë 29 qershor 1998 “Për mbrojtjen e të drejtave të pensionit suplementar të të punësuarve dhe të vetëpunësuarve, kur lëvizin brenda Komunitetit”;
- Direktivën 2014/50 BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit “Mbi kërkesat minimale të nxitjes së lëvizjes së punëtorëve në vendet e BE-së, duke përmirësuar njohjen dhe ruajtjen e të drejtave të pensionit suplementar”.

Ekspertët e BE-së dhanë shpjegime dhe prezantuan pikat kryesore të këtij kapitulli. Të gjitha institucionet kishin dërguar paraprakisht pyetjet e tyre lidhur me kuadrin rregullator që lidhet me çështjet që ato kanë nën mbikëqyrje. Disa nga pyetjet e bëra u transmetuan drejtpërdrejt edhe me shpjegimet përkatëse.

Në shpjegim të pyetjeve të shtruar nga ekspertët e AMF-së, lidhur me funksionimin e planit të pensionit profesional dhe ndryshimin apo kostot që mund të ketë në procesin e përshtatjes së legjislacionit tonë me direktivat e BE-së, ekspertët e BE-së dhanë disa sqarime. Ata theksuan se: “Duhet të respektohet parimi i trajtimit të barabartë, pra jo diskriminim për shkak të shtetësisë, do të thotë për shembull, se nëse një anëtar në një fond pensioni ka lehtësira për shembull në taksa, këto duhet t'i përfitojë edhe në rastin kur ata lëvizin nga një vend anëtar tek tjetri.”

Takimi u zhvillua edhe me diskutime dhe pyetje të tjera nga grupi i punës i AMF-së për problematika që lidhen me këtë kapitull dhe lëvizjen e lirë të punëtorëve dhe skemat e pensioneve suplementare. Në shpjegime u cilësua edhe për procesin e hartimit të akteve të reja nënligjore apo amendimeve që lidhen me kërkesat për licencimin e fondeve profesionale të pensionit për t'ju përshtatur sa më mirë direktivave të Bashkimit Evropian.

Komisioni Evropian, në kuadër të procesit *screening*, organizoi në Bruksel me datë 13 mars takim shpjegues me përfaqësuesit e Komisionit Evropian, ministrive dhe institucioneve pjesëmarrëse në këta kapituj.

Pjesëmarrje në Kolegjin e Dytë të Grupit të Sigurimeve Eurosig në Shkup, Maqedoni

Përfaqësues nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, morën pjesë në Kolegjin e Dytë të Grupit të Sigurimeve Eurosig të mbajtur në Shkup, Maqedoni në datën 11 mars 2019. Mbikëqyrja e grupeve bazohet në Udhëzimin Metodologjik “Mbi mbikëqyrjen e grupit të sigurimit”, miratuar në vitin 2018.

Në takim, krahas përfaqësuesve të Autoritetit, ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) dhe përfaqësues të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë (ISA). Në takim u prezantua situata financiare dhe zhvillimet më të fundit të shoqërisë “Eurosig Maqedoni” nga përfaqësues të ISA. Më pas u prezantua situata financiare dhe rreziqeve kryesore të shoqërive “Eurosig sh.a.” dhe “Insig sh.a.” në Shqipëri, u prezantua situata financiare dhe problematikat e Shoqërive “Insig, Dega Kosovë” dhe “Eurosig Kosovë” nga përfaqësues të BQK-së.

Nga ana e përfaqësuesve të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë u krye prezantimi i modelit të vlerësimit të cilësisë së qeverisjes korporative në kompanitë e sigurimeve në Republikën e Maqedonisë, si dhe disa nga rezultatet e vlerësimit të kryer.

Në përfundim të takimit, u diskutua për vazhdimësinë e shkëmbimeve periodike, çdo 3-muaj, të të dhënave lidhur me treguesit e shoqërive, si dhe njoftimin reciprok për çdo zhvillim të rëndësishëm, përfshirë dhe masa nga bordet përkatëse.

Zhvillohet Konferenca e 20-të vjetore e Bursës, Maqedoni

Bursa e Maqedonisë së Veriut në bashkëpunim me Komisionin e Mbikëqyrjes së Tregut të Letrave me Vlerë të Maqedonisë zhvilluan në datën 29 mars, në Ohër, Maqedoni, Konferencën e 20-të Vjetore të Bursës.

Kryeministri i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Z. Zoran Zaev, vuri theksin rëndësinë e tregut të kapitalit dhe domosdoshmërinë e zhvillimit të mëtejshëm të tij. Konferenca ishte një mundësi e mirë për shkëmbimin e opinioneve dhe informacioneve në funksion të një mbikëqyrjeje efektive të tregut të kapitalit, duke u nisur edhe nga fakti se Bursa Shqiptare e Titujve, nën mbikëqyrjen e AMF-së, është e re në funksionimin e saj.

Përfaqësues nga
Autoriteti i Mbikëqyrjes
Financiare, departamenti
i Mbikëqyrjes së Tregut
të Sigurimeve, morën
pjesë në Kolegjin e Dytë
të Grupit të Sigurimeve
Eurosig të mbajtur në
Shkup, Maqedoni në
datën 11 mars 2019.

Disa nga temat kryesore të diskutuara ishte:

- Financimi për zhvillimin e korporatave;
- Pse janë të rëndësishme bursat lokale;
- Blerjet dhe shkrirjet e institucioneve financiare në Evropën Juglindore;
- Teknologjitë e reja në Tregun e Kapitalit;
- Inteligjenca artificiale si aktor i ri në botën e biznesit;
- Viti i obligacioneve;
- Zbatimi i Direktivës *MIFID II* në vendet e vogla: Leksionet e mësuara;
- Përgatitja e emetimeve fillestare me ofertë publike (IPO).

Në përfundim të konferencës u ndanë çmimet për kompaninë më transparente të vitit, të listuara në Bursën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Zhvillohet Kolegji i Mbikëqyrjes për Grupin e Sigurimit Vienna Insurance Group (VIG)

Në datat 28-29 mars 2019, në Vjenë, Austri u zhvillua mbledhja e Kolegjit të Mbikëqyrjes për Grupin e Sigurimit Vienna Insurance Group (VIG). Mbledhja u nda në tre faza:

Faza e parë konsistoi në prezantimin e çështjeve kryesore të identifikuar dhe masat e marra në vlerësim të rrezikut gjatë vitit të shkuar, duke përfshirë këtu edhe rezultatet e analizës së vetëvlerësimit (ORSA) të nxjerra nga analizat e provës së rezistencës, të kryera mbi VIG Group nga EIOPA. Gjithashtu u bë edhe një përmbledhje e aktiviteteve kryesore për këtë grup gjatë vitit. Në këtë takim u diskutua lidhur me formatin e ri në për paketën e shkëmbimit të informacionit midis autoriteteve. Gjithashtu u prezantuan objektivat dhe pritshmëritë nga ana e mbikëqyrësve të grupit, si dhe u diskutua në lidhje me afatet e planifikimeve të autoriteteve individuale.

Faza e dytë kishte prezantime të përfaqësuesve të autoriteteve të çdo vendi mbi çështjet kryesore dhe zhvillimet e tregut gjatë vitit 2017, por dhe 2018, si dhe mbi specifikat dhe risqet kryesore të Grupit VIG në vendet e tyre. Të gjitha çështjet kryesore nga raportimet u përmbledhën në një material nga përfaqësuesit e Autoritetit Austriak të Tregut Financiar, si një analizë përmbledhëse nga Kolegji për t'u ndarë me Grupin VIG.

Në datat 28-29 mars 2019, në Vjenë, Austri u zhvillua mbledhja e Kolegjit të Mbikëqyrjes për Grupin e Sigurimit Vienna Insurance Group (VIG).

Gjithashtu u paraqit dhe u diskutua plani për zhvillimin e inspektimeve të përbashkëta midis FMA si mbikëqyrëse e grupit VIG dhe autoriteteve të vendeve ku ky grup vepron, përfshirë dhe Shqipërinë. Ky inspektim i përbashkët është planifikuar të zhvillohet në vitin 2020.

Faza e tretë përfshiu prezantimin nga përfaqësues të menaxhimit të të dhënave financiare për Grupin VIG në vitin 2017 dhe objektivat e 2018. Gjithashtu:

- U detajuan masat strategjike në nivel Grupi, zhvillimet kryesore të biznesit, si dhe sfidat e tregut;
- Zbatimi i IFRS9/IFRS 17 duke përfshirë projektplanet mbi zbatimin e ndryshimeve të pritshme të këtyre standardeve;
- Mbështetja e dhënë nga grupi për shoqëritë në nivel lokal.

Në takim pati diskutime dhe pyetje drejtuar manaxhimit të VIG Group, mbi problematikat e hasura nga autoritetet mbikëqyrëse gjatë inspektimeve *on-site* dhe *off-site* në shoqëritë e VIG Group në nivel lokal.

Në përfundim të kolegjit u prezantuan përmirësimet dhe pritshmëritë nga zhvillimi mbledhjeve të Kolegjit të Mbikëqyrjes për Grupin e Sigurimit Vienna Insurance Group (VIG), si dhe gjetjet kryesore nga inspektimet *on-site* dhe *off-site* të kryera prej Autoritetit Austriak të Tregut Financiar.

Në takim u bë prezantim i direktivave që i përkasin Kapitullit 28 “Mbrotjtja Konsumatore” të cilat duhet të përafrohen nga shteti shqiptar në kuadër të anëtarësimit në BE.

Takime shpjeguese për Kapitullin e 28-të “Mbrotjtja e Konsumatorit” organizuar nga Komisioni Evropian

Komisioni Evropian, në kuadër të procesit *screening*, organizoi në Bruksel me datë 28 mars Takimin Shpjegues me përfaqësuesit e Komisionit Evropian, ministrive dhe institucioneve pjesëmarrëse në Kapitullin 28 “Mbrotjtja e Konsumatorit”. Në këtë takim delegacioni shqiptar u informua mbi legjislacionin dhe standartet e Bashkimit Evropian që lidhen me këtë kapitull negociues.

Në takim u bë prezantim i direktivave që i përkasin Kapitullit 28 “Mbrotjtja Konsumatore” të cilat duhet të përafrohen nga shteti shqiptar në kuadër të anëtarësimit në BE. Direktivat e këtij kapitulli ndikojnë konsumatorin në përgjithësi, ndërsa lidhur me mbrotjtjen e konsumatorit në tregjet financiare bankare dhe jobankare direktivat do trajtohen të detajuara në takimin shpjegues lidhur me kapitullit 9-të.

Ekspertët e BE-së dhanë shpjegime dhe prezantuan pikat kryesore të këtij kapitulli. Takimi u zhvillua me diskutime dhe pyetje për problematika që lidhen me këtë kapitull.

Zhvillohet Kolegji i Mbikëqyrjes së Grupit të Sigurimit UNIQA

Në datat 11-12 mars u zhvillua në Vjenë, Austri, mbledhja dy-ditore e kolegjit të mbikëqyrjes për Grupin e Sigurimit UNIQA (UIG) organizuar nga Autoriteti Austriak i Tregut Financiar (FMA).

Takimi u nda në katër sesione:

- Në sesionin e parë u prezantuan çështjet kryesore të identifikuara dhe masat e marra për vlerësimin e rrezikut gjatë vitit të kaluar. Gjithashtu u prezantuan edhe rezultatet e analizës së vetëvlerësimit (ORSA), rezultate të nxjerra nga analizat e provës së rezistencës, të kryera mbi UIG nga EIOPA, si dhe një përmbledhje të aktiviteteve kryesore *on-site* dhe *off-site* gjatë vitit 2018;
- Sesioni i dytë ishte i organizuar me prezantimin e përfaqësuesve të Autoriteteve të çdo vendi mbi çështjet kryesore dhe zhvillimet e tregut gjatë vitit 2017 dhe nëntëmujorit të 2018, si dhe mbi specifikat dhe risqet kryesore të UIG në vendet e tyre. Në këtë seksion u diskutua mundësia e zhvillimit të inspektimeve të përbashkëta midis FMA dhe mbikëqyrësve të tjerë në shoqëritë e sigurimit të UIG.
- Në sesionin e tretë Wolfgang Kindl, Drejtor i Përgjithshëm i UNIQA International AG, Kryetar i Bordit të Menaxhimit dhe Kurt Svoboda, Drejtor i Financës dhe Rrezikut, UNIQA Insurance Group AG, Anëtar i Bordit të Menaxhimit, prezantuan të dhënat financiare për grupin për vitin 2017, dhe nëntëmujorin e vitit 2018. U prezantuan edhe masat strategjike në nivel grupi dhe individual bazuar në rezultatet e vetëvlerësimit (ORSA) të grupit, si dhe të strategjisë së investimeve në sisteme të IT-së, ndryshimet thelbësore në reduktimin e pjesëmarrjeve të Grupit UNIQA në Itali;
- Sesioni i katërt konsistoi në një prezantim nga ana FMA lidhur me mënyrën dhe afatet dhe çështjet që do të trajtohen në kolegjin e ardhshëm.

Së fundi, të gjitha çështjet kryesore nga raportimet u përmbledhën në një material nga përfaqësuesit e Autoritetit Austriak të Tregut Financiar si një analizë përmbledhëse nga Kolegji për t'u ndarë me Grupin UNIQA.

—○○○—
Në datat 11-12 mars u zhvillua në Vjenë, Austri, mbledhja dy-ditore e kolegjit të mbikëqyrjes për Grupin e Sigurimit UNIQA (UIG) organizuar nga Autoriteti Austriak i Tregut Financiar (FMA).



Të kursesh mjaftueshëm, mirë dhe në mënyrë inteligjente

Evropa po plaket dhe kjo përbën një sfidë për qeveritë evropiane për t'u siguruar që njerëzit të kenë të ardhura dinjitoze kur të dalin në pension. "Insurance Europe", Shoqata e Siguruesve dhe Risiguruesve Evropianë ka përgatitur një dokument ku propozohen mënyra që ndihmojnë qytetarët evropianë të kursejnë mjaftueshëm, mirë dhe në mënyrë inteligjente për pensionin e tyre. Shumë vende evropiane kanë nisur tashmë të reformojnë sistemet e tyre të pensioneve. Por kjo nuk është e mjaftueshme. Sipas OECD-së, qytetarët duhet të marrin përgjegjësi personale dhe të japin më shumë kontribut të shtrirë në kohë, nëse duan të kenë të ardhura të përshtatshme për pensionin.

(pjesa e parë, me shkurtime e redaktime)

Një Plan për Pensionet

Evropa përballet me një sfidë të paprecedentë të pensioneve, pasi i ashtuquajtuari bumi i lindjeve po afrohet gjithnjë e më tepër me moshën e daljes në pension dhe si rrjedhojë pritshmëritë e jetës rriten.

Raporti i varësisë së moshës së tretë në Evropë, që është raporti mes numrit të njerëzve të moshës 65 vjeç e lart në krahasim me ata të moshës 15 deri në 64 vjeç, pritet të dyfishohet deri në vitin 2060. Nëse sot një pensionist mbulohet mesatarisht nga 4 punonjës, në të ardhmen do të ketë vetëm dy të tillë.

Kjo do të ketë implikime të thella në qëndrueshmërinë e sistemeve kombëtare pensionale statutore, të cilat financohen në bazën *Pay-As-You-Go* (PAYG). Sistemet PAYG transferojnë kontributet e sigurimeve shoqërore nga punonjësit tek pensionistët dhe prandaj janë shumë të ekspozuar ndaj ndryshimeve demografike.

Nëse nuk bëhet asgjë për të ndryshuar këtë, plakja e popullsisë në të gjithë Evropën do të krijojë një hendek të madh midis kontributeve që shtetet anëtare të Bashkimit Evropian mbledhin nga sigurimet shoqërore dhe pagesat e pensioneve që ata kryejnë, duke rritur barrën mbi financat publike.

Nevoja për të promovuar kursimet private

Sistemet e pensioneve me shumë shtylla konsiderohen si mënyra më efektive për të përballuar sfidat demografike me të cilat përballen sistemet e pensioneve dhe për të përmbushur objektivin e dyfishtë të qëndrueshmërisë së sistemeve dhe përshtatshmërinë e të ardhurave për pensionet. Sistemet me shumë shtylla përfshijnë plotësimin e të ardhurave publike të daljes në pension (siç i referohemi zakonisht si "shtylla e pare") së bashku me dy shtyllat e tjera të financuara të pensioneve:

Sistemet e pensioneve me shumë shtylla konsiderohen si mënyra më efektive për të përballuar sfidat demografike me të cilat përballen sistemet e pensioneve dhe për të përmbushur objektivin e dyfishtë të qëndrueshmërisë së sistemeve dhe përshtatshmërinë e të ardhurave për pensionet.

Fleksibiliteti dhe reagimi i sektorit të sigurimeve do të thotë se siguruesit ofrojnë një gamë të gjerë të produkteve të pensioneve dhe sigurimeve të përshtatura për kulturat dhe nevojat e tregjeve të ndryshme.

■ Shtylla e dytë, ose “pensionet profesionale”, që përbëhen nga skemat e pensioneve të financuara të lidhura me një kontratë pune ose një aktivitet profesional. Këto në përgjithësi përcaktohen nga punëdhënësit në nivel ndërmarrjeje apo sektori, shpesh me përfshirjen e punonjësve ose përfaqësuesve të punonjësve. Në disa vende, të vetëpunësuarit mund të kenë qasje në këtë lloj produkti. Pensionet profesionale ofrohen kryesisht nga institucionet financiare si siguruesit e Jetës ose fondet e pensioneve.

■ Shtylla e tretë, ose “pensionet personale”, që përbëhen nga kursimet vullnetare për daljen në pension. Këto janë produkte të aksesueshme nga individët mbi baza vullnetare. Siguruesit e Jetës janë deri më tani ofruesit më të mëdhenj të tyre në Evropë.

Sistemet e pensioneve me shumë shtylla kanë përparësi të konsiderueshme të diversifikimit të rreziqeve, pasi faktorët që ndikojnë më së shumti në shtyllën e parë (dinamika e tregut të punës, ndryshimet demografike, financat publike) nuk lidhen plotësisht me ato që ndikojnë në shtyllat e dyta dhe të treta, (paqëndrueshmëria e tregut dhe inflacioni).

Roli i siguruesve të Jetës

Duke u konsideruar si siguruesit kryesorë të pensioneve profesionale dhe atyre personale, siguruesit janë pjesë përbërëse e çdo sistemi me shumë shtylla. Ajo që i dallon siguruesit është aftësia e tyre për të siguruar mbrojtje për rreziqe shumë të ndryshme të jetës.

Këto përfshijnë dispozitat për personat në ngarkim, nëse kursimtari ose përfituesi vdes para kohe (rreziku i vdekshmërisë), mbrojtja nëse kursimtarët nuk janë në gjendje të paguajnë kontributet për shkak të paafësisë (rreziku i sëmundjes) dhe mbrojtja e pasurive që lidhen me rritjen e jetëgjatësisë (rreziku i jetëgjatësisë). Rreziqet mund të mbulojnë si në fazën e akumulimit, ashtu edhe nëpërmjet të ardhurave vjetore - faza e pagesës.

Fleksibiliteti dhe reagimi i sektorit të sigurimeve do të thotë se siguruesit ofrojnë një gamë të gjerë të produkteve të pensioneve dhe sigurimeve të përshtatura për kulturat dhe nevojat e tregjeve të ndryshme.

Këto mund të mbulojnë akumulimin dhe/ose dekulimin e pensioneve dhe përfshijnë:

■ **Të ardhurat vjetore dhe produktet e tjera ku pagesat për policëmbajtësin janë fikse dhe të garantuara.** Kthimi i investimit bëhet i mundur kur klienti blen anuitetin, së bashku me jetëgjatësinë, përcakton pagesat që siguruesi është në gjendje t'i ofrojë klientit.

- **Produktet me kthime të garantuara.** Klienti nuk mbart rrezik investimi, por ka sigurinë e një kthimi të paracaktuar dhe të garantuar.

- **Produkte me dispozita për ndarjen e fitimit.** Këto produkte mund të përfshijnë pagesat minimale të garantuara dhe shtesat përmes mekanizmave për ndarjen e fitimit. Niveli i garancisë që mund të ofrohet, ndikohet nga performanca e pritshme e investimeve. Pagesat nga ndarja e fitimit varen nga tejkalimi i performancës aktuale të pritshme të investimeve dhe në ndryshimin mes normave të vdekshmërisë së pritshme dhe ato aktuale.

- **Produktet e Jetës me karakteristikat e investimit.** Përveç mbulimit të rrezikut, kthimet e investimeve janë pjesë përbërëse e vetë produkteve.

- **Produktet për mbrojtjen.** Këto produkte mbulojnë kryesisht rreziqet. Masat e politikave për të mbrojtur kursimet për pensionin duhet të jenë të balancuara, proporcionale dhe me rëndësi të qëndrueshme. Përndryshe, disponibiliteti i produkteve të kursimeve të pensionit mund të pësojë ndikim negativ.

JOURNAL OF RISK MANAGEMENT IN FINANCIAL INSTITUTIONS


Volumi 12 përmban këto shkrime kryesore:

- Metodologji për menaxhimin e rreziqeve dhe pasigurive
(*A methodology for actively managing tail risks und uncertainties*)
- Parashikimi i rrezikut të kredisë sipas SNRF 9
(*Credit risk forecasting modelling and projections under IFRS 9*)

GLOBAL RISK REGULATOR

Volumi 17, nr. 3, mars 2019 përmban këto shkrime kryesore:

- Eurozona mund të mos jetë gati për një krizë tjetër
(*Eurozone may not be ready for another crisis*)
- Stres-testet e BE-së zbulojnë shqetësime
(*EU Stress tests reveal concerns*)



Global Risk Regulator

A PUBLICATION FROM THE BANKER March 2019 | Volume 17, Issue 3

Contents

5 Harmonising data to alleviate regulatory fragmentation
8 US Regulatory Round-up
10 Eurozone may be ready for another crisis
12 EU stress tests reveal concerns
13 CCPs geared for
14 No-dual Brexit
Newsroom (15-18)
US and UK move to safeguard derivatives markets: Their country access to EU financial markets contingent on equivalent rules
ASIC engages business school to assess MFSD

G20 leaders urged to tackle regulatory fragmentation

There is a real risk that the fragmentation of global capital markets could eventually see them grinding to a halt with all kinds of negative consequences for the real economy. This has focused the FSB and the G20 to try and come up with a solution. By Justin Pugley

Regulatory fragmentation is likely to be revealed as an increasingly serious problem that is eroding global capital markets and financial stability when the Financial Stability Board (FSB) reports to the G20 in June.

In its 2018 third quarter newsletter, the International Capital Market Association (ICMA) published an article raising its concern that public officials and some market participants may not be fully cognisant of the level of global capital market integration.

"Open and integrated international capital markets are under threat from political and



Andrew Purtilo

economic pressures from protectionism and fragmentation in a number of ways," the article said. It identified pressures such as the UK's vote to leave the EU, doubts about the future composition of the eurozone and risks of regulatory divergence between jurisdictions.

The challenge for the industry is creating regulatory fragmentation, and as ICMAs admits it is impossible to come up with a reliable estimate. However, it could be costing financial

Bullgari

www.xprimm.com

Volumi i primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Bullgari gjatë vitit 2018 arriti në 2.52 miliardë leva (BGN, monedha vendase) ose 1.29 miliardë euro, me një rritje prej 16%. Rritjen më të madhe e pati tregu i sigurimeve të Jo-Jetës me 19.1%, me një total prej 2.08 miliardë leva (1.06 miliardë euro), ndërsa tregu i sigurimeve të Jetës u rrit me 3.69%, me një total prej 444.47 milionë leva prime të shkruara bruto (ose 227.5 milionë euro).

Kroaci

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të Byrosë Kroate të Sigurimeve, për muajin shkurt 2019, primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve arritën në 1.81 miliardë kuna (HRK, monedha vendase) ose 245 milionë euro, me një rritje prej 5.76% krahasuar me muajin shkurt të vitit të kaluar. Sigurimi i Jo-Jetës zotëron 76.51% të tregut, ndërsa ai i Jetës 23.49%.

Në shkurt 2019 primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 1.39 miliardë kuna (188 milionë euro), me një rritje prej 10.27%. Ndërsa primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën në 427 milionë kuna (58 milionë euro), me një rënie prej 6.69%.

Hungari

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve në Hungari në vitin 2018 gjeneroi mbi 1 trilionë forinta (HUF, monedha vendase) ose 3.2 miliardë euro, me një rritje prej 7.1%. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën në 476.7 miliardë forinta, ose 1.5 miliardë euro, me një rritje prej 3.5%.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës kapën shifrën 547.3 miliardë forinta, 1.7 miliardë euro, me një rritje vjetore prej 10.5%. Në sigurimin e Jetës, primet e shkruara bruto ishin 476.7 miliardë forinta, 1.5 miliardë euro, me një rritje vjetore prej 3.5%.

Poloni

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto për vitin 2018 në tregun e sigurimeve në Poloni arritën në 62.17 miliardë zlota (PLN, monedha vendase), ose 14.5 miliardë euro, duke ruajtur të njëjtat nivele me ato të një viti më parë.

Në vitin 2018 u paguan 9.7 miliardë euro dëme, me një rritje prej 4.7%. Sigurimi i Jetës vijoi trendin negativ të viteve të fundit, me 21.7 miliardë zlota prime të shkruara bruto, me një rënie prej 11.6%. Sa i përket sigurimit të Jo-Jetës, primet e shkruara bruto në sigurimin e pronës shënuan rritjen më të madhe, me 9.12%, duke arritur në 6.8 miliardë zlota. Rritje shënoi edhe sigurimi motorik, me 4.5%, duke arritur në 23.5 miliardë zlota.

Rumani

www.xprimm.com

Primet e shkruara bruto në Rumani arritën në 2.17 miliardë euro në vitin 2018, ndërsa dëmet e paguara ishin 1.27 miliardë euro. Në total, tregu u rrit me 92 milionë euro, ose 4.44% krahasuar me vitin 2017. Pagesa e dëmeve u rrit me 16.97%, kryesisht për aksidentet e shkaktuara në sigurimin motorik.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës ishin 450 milionë euro, me një rritje prej 4.17%. Ndërsa në sigurimin e Jo-Jetës, primet e shkruara bruto arritën në 1.72 miliardë euro, me një rritje prej 4.51%. Sigurimi i Jetës dhe Jo-Jetës vijojnë të ruajnë prej 10 vitesh të njëjtën peshë në treg, respektivisht 20.75% sigurimi i Jetës dhe 79.25% sigurimi i Jo-Jetës.

Sllovaki

www.xprimm.com

Në Sllovaki, sipas përlogaritjeve të bëra nga Byroja e Sigurimeve vlerësohet se rreth 241 mijë automjete kanë qarkulluar gjatë vitit 2018 pa një siguracion të vlefshëm TPL. Përmes Fondit të Garancisë, Byroja Sllovake e Sigurimeve ka paguar 2706 raste dëmshpërblimesh, si rezultat i aksidenteve të shkaktuara nga mjettet e pasiguruara.

Sipas të dhënave zyrtare për vitin 2018, siguracion të vlefshëm kishin 2,980,605 automjete. Kjo shifër tregon një rritje prej 4% krahasuar me vitin e kaluar. Gjatë vitit 2018, Fondi i Garancisë në Sllovaki pagoi në total 6.7 milionë euro për aksidentet e shkaktuara nga mjete të pasiguruara ose pa autor, me një rritje prej 221% krahasuar me vitin e kaluar.

Turqi

www.xprimm.com

Volumi i primeve të shkruara bruto për vitin 2018 në tregun e sigurimeve në Turqi arriti në 54.6 miliardë lirave (TRY, monedha vendase), ose 9 miliardë euro. Kjo shënon një rritje prej 17.4% krahasuar me vitin 2017. Në vlerësimet e bëra me monedhën evropiane, tregu rezulton me rënie, për shkak të zhvlerësimit të monedhës vendase nga 4.52 lira në dhjetor 2017 në 6.05 lira për një euro në dhjetor 2018. Sigurimi i Jo-Jetës arriti në 47.7 miliardë lira prime të shkruara bruto, me një rritje prej 20.2%, ndërsa sigurimi i Jetës 6.9 miliardë lira, me një rritje prej 1%.



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al